VENDIM
Nr. 22, datë 27.2.2014

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË RREGULLOREN "PËR ADMINISTRIMIN E RREZIKUT TË KREDISË NGA BANKAT DHE DEGËT E BANKAVE TË HUAJA"

Në bazë dhe për zbatim të nenit 12, shkronja "a" dhe nenit 43, shkronja "c" të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të neneve 57, 58, 61 dhe 68 të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë", me propozim të Departamentit të Mbikëqyrjes, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë

VENDOSI:

1. Në rregulloren "Për administrimin e rrezikut të kredisë nga bankat dhe degët e bankave të huaja", miratuar me vendimin nr. 62, datë 14.9.2011 dhe ndryshuar me vendimin nr. 27, datë 27.3.2013 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, të bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) Në nenin 11, paragrafi 1, togfjalëshi "të paktën një herë në 3 (tre) muaj", bëhet "çdo muaj";

b) Përmbajtja e nenit 11, paragrafi 2, shkronja "e", pika "i", ndryshon si më poshtë vijon:

"i) gjendja financiare e kredimarrësit vlerësohet qartë se nuk siguron përmbushjen e plotë të kushteve të shlyerjes së kryegjësë dhe të interesit; ose vlerësohet se mungon i gjithë dokumentacioni i nevojshëm për përcaktimin e gjendjes financiare; ose kredimarrësi është në paaftësi paguese/ka falimentuar, është përfshirë në proces likuidimi; ose kredimarrësi ka vdekur dhe askush nuk mund të paguajë kredinë; ose banka ka depozituar te përmbaruesi gjyqësor kërkesën për fillimin e procesit të ekzekutimit të detyrueshëm të kolateralit, në rast se kredia është e siguruar me kolateral; ose gjykata ka lëshuar urdhrin e ekzekutimit, në rast se kredia nuk është e siguruar me kolateral.

Përjashtim nga kushti i fundit i kësaj pike, bëjnë ato kredi, të cilat u janë nënshtruar procesit të ristrukturimit dhe plotësojnë kushtet e nenit 13, paragrafit 2, shkronja "a" dhe "b" të kësaj rregulloreje.".

c) Përmbajtja e nenit 11, paragrafi 3, shkronja "e", pika "i", ndryshon si më poshtë vijon:

"i) gjendja financiare e kredimarrësit vlerësohet qartë se nuk siguron përmbushjen e plotë të kushteve të shlyerjes së kryegjësë dhe të interesit; ose vlerësohet se mungon i gjithë dokumentacioni i nevojshëm për përcaktimin e gjendjes financiare; ose kredimarrësi është në paaftësi paguese/ka falimentuar, është përfshirë në proces likuidimi; ose kredimarrësi ka vdekur dhe askush nuk mund të paguajë kredinë; ose banka ka depozituar te përmbaruesi gjyqësor kërkesën për fillimin e procesit të ekzekutimit të detyrueshëm të kolateralit, në rast se kredia është e siguruar me kolateral; ose gjykata ka lëshuar urdhrin ekzekutimit, në rast se kredia nuk është e siguruar me kolateral.

Përjashtim nga kushti i fundit i kësaj pike bëjnë ato kredi, të cilat u janë nënshtruar procesit të ristrukturimit dhe plotësojnë kushtet e nenit 13, paragrafit 2, shkronjat "a" dhe "b" të kësaj rregulloreje.".

d) Përmbajtja e nenit 17, ndryshon si më poshtë vijon:

i) paragrafi 2 rinumërohet dhe bëhet paragrafi 3;

ii) pas paragrafit 1 shtohet paragrafi 2 dhe 3 me përmbajtjen si vijon:

"2. Në çdo rast banka fshin kreditë, jo më vonë se tri vite pas klasifikimit të tyre në klasën "të humbura". Gjatë kësaj periudhe, banka merr masat e nevojshme për plotësimin e kushteve të përcaktuara në legjislacionin tatimor për fshirjen e kredive.

3. Përjashtim nga kërkesa e paragrafit 2 të këtij neni bëjnë:

a) kreditë, për të cilat në vendimmarrjen e vetë bankës dhe vetëm pas miratimit të Bankës së Shqipërisë, argumentohet se mbështetur në analizën gjendjes financiare të kredimarrësit dhe në cilësinë e kolateralit, vërtetohet mundësia efektive e kolateral; ose gjykata ka lëshuar urdhrin e ekzekutimit, në rast se kredia nuk është e siguruar me kolateral.

Përjashtim nga kushti i fundit i kësaj pike, bëjnë ato kredi, të cilat u janë nënshtruar procesit të ristrukturimit dhe plotësojnë kushtet e nenit 13, paragrafit 2, shkronja "a" dhe "b" të kësaj rregulloreje.".

c) Përmbajtja e nenit 11, paragrafi 3, shkronja "e", pika "i", ndryshon si më poshtë vijon:

"i) gjendja financiare e kredimarrësit vlerësohet qartë se nuk siguron përmbushjen e plotë të kushteve të shlyerjes së kryegjësë dhe të interesit; ose vlerësohet se mungon i gjithë dokumentacioni i nevojshëm për përcaktimin e gjendjes financiare; ose kredimarrësi është në paaftësi paguese/ka falimentuar, është përfshirë në proces likuidimi; ose kredimarrësi ka vdekur dhe askush nuk mund të paguajë kredinë; ose banka ka depozituar te përmbaruesi gjyqësor kërkesën për fillimin e procesit të ekzekutimit të detyrueshëm të kolateralit, në rast se kredia është e siguruar me kolateral; ose gjykata ka lëshuar urdhrin e ekzekutimit, në rast se kredia nuk është e siguruar me kolateral.

Përjashtim nga kushti i fundit i kësaj pike bëjnë ato kredi, të cilat u janë nënshtruar procesit të ristrukturimit dhe plotësojnë kushtet e nenit 13, paragrafit 2, shkronjat "a" dhe "b" të kësaj rregulloreje.".

d) Përmbajtja e nenit 17, ndryshon si më poshtë vijon:

i) paragrafi 2 rinumërohet dhe bëhet paragrafi 3;

ii) pas paragrafit 1 shtohet paragrafi 2 dhe 3 me përmbajtjen si vijon:

"2. Në çdo rast banka fshin kreditë, jo më vonë se tri vite pas klasifikimit të tyre në klasën "të humbura". Gjatë kësaj periudhe, banka merr masat e nevojshme për plotësimin e kushteve të përcaktuara në legjislacionin tatimor për fshirjen e kredive.

3. Përjashtim nga kërkesa e paragrafit 2 të këtij neni bëjnë:

a) kreditë, për të cilat në vendimmarrjen e vetë bankës dhe vetëm pas miratimit të Bankës së Shqipërisë, argumentohet se mbështetur në analizën gjendjes financiare të kredimarrësit dhe në cilësinë e kolateralit, vërtetohet mundësia efektive e shlyerjes/ripagimit të saj; dhe

b) kreditë në proces ristrukturimi, për të cilat në çdo rast, përjashtimi nga kërkesat e këtij neni, nuk mund të tejkalojë një periudhë 6-mujore që nga dita që kredia ka plotësuar kushtet për t'u fshirë.".

2. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes të Bankës së Shqipërisë për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

3. Ngarkohet Kabineti i Guvernatorit për publikimin e këtij vendimi në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi në datën 1 janar 2015.

KRYETARI
Ardian Fullani